



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-2862/24 datë: 25.01.2024



Npi – 01/50 datë: 29.01.2024

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 29.01.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S Ë - I - T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E
E mbajtur më: 29.01.2024 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, znj.Shkurte Mustafa, znj.Shkurte Behluli, z.Muhamet Mehmeti, në mbledhje nuk ka marrë pjesë z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF, z.Bardhyl Rushiti drejtor i DSHP, znj.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS, nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 26.12.2023,
2. Diskutim për 15 shkurtin – Dita Nacionale e komunitetit Ashkali,
3. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2024,
4. Raport Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023,
5. Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik),
6. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit,
7. Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)
8. Propozim-Vendim për ndarjen e subvenc. për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024,
9. Propozim-Vendim për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërrmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes
10. Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës. Konstatoj që në mbledhje janë 6 anëtarë prezent, mungon Arton Demiri.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 26.12.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26.12.2023.**

Pika 2

Diskutim për 15 shkurtin – Dita Nacionale e komunitetit Ashkali

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne kemi miratuar një Rekomandim për 15 Shkurtin që ta marrë përsipër organizimin e kësaj dite DKRS-ja, tash po e pyes drejtoreshën se sa ka mundësi të organizohet kjo nga ana juaj.

znj.Albana Fazliu, DKRS; Përshëndetje, ne buxhet të destinuar për këtë çështje nuk kemi dhe me organizu nuk mundemi pa buxhet. Herave tjera ju e keni organizuar nëpërmjet një këshilli organizativ. Dua të them se si drejtori ne nuk kemi ndonjë buxhet të caktuar as për 17 Shkurtin ditën e Pavarsis. Unë po provojë më bërë diqka sa të mundem me organizu edhe pa mjete.

z.Bardhyl Rushiti, DSHP; Përshëndetje, buxhet nuk ka dhe sa po shohë unë ndoshta do të ishte mirë për të ardhmen që të sigurohen mjetet nga buxheti.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pavarsisht situatave ne si KPK-ë e kemi marrë një rekomandim. Ne realisht e kemi marrë rekomandimin më herët dhe nuk është marrë për bazë pikërisht për shkak të mungesës së juaj në mbledhje. Megjithatë ne e kemi një propozim që ta bëjmë një zgjidhje, vitin e kaluar kanë qenë 500 euro për ta shënuar këtë ditë, ndoshta mundeni edhe këtë vit me bërë të njëjtën.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ndoshta drejtoresha mundet me u taku me organizatat joqeveritare lokale për me i rimbursuar pastaj këto aktivitete. Ne kemi kërkuar bile edhe me u rritë shuma e mjeteve.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, e falenderojmë drejtoreshen dhe Kryetarin për përkrahjen, në vitin e kaluar mirpo ne kemi hasur në vështërsi. Kemi bërë organizimin dhe kemi hasur në pengesa sepse aktivitetet nuk u përputhshin. Ne si staf i këshillit organizativ kemi vendosur që DKRS me organizu. Kjo nuk ka ndodhë asnjëher por duhet me gjetë një rrugë. Vjet ja kemi kthyer personit paret tek pas një viti, dhe tash ai nuk po don më me rreziku. Vitin e ardhshëm si drejtoreshë është mirë me bërë njëfar organizimi. E di që për vitin 2024 nuk ka buxhet për këtë është zero.

znj.Albana Fazliu, DKRS; Ndoshta nga të hyrat mundë të ndahen pak mjete.

z.Bardhyl Rushiti, DSHP; Ndoshta është mirë me bë një kornizë kontratë.

Pika 3

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Propozoj që te pika 3.8 në rregullore të bëhen këto ndryshime në vend të fjalës (RAE) të zëvendësohet me fjalët (Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian), dhe te neni 12.1.6 të futet nga lirimi edhe pjestarët e Komunitetit Rom Ashkali.

znj.Rrezartë Ramadani; Kjo është diskriminim për komunitetin shumicë, unë mendoj se duhet të luftohet për barazi e jo për të krijuar diskriminim në dëm të një komuniteti tjetër.

z.Besnik Seferi; Nuk dua me fol për sa u përket Veteranëve sepse tash më ka kaluar një kohë mbi 20 vjet dhe realisht më nuk ka edhe aq fëmijë të veteranëve, që 20 vite ka përfundu lufta.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Është një inkurajim i mirë për komunitetin.

z.Besnik Seferi; Mendoj se kjo rregullore është shumë mirë, por eventualisht te rregullorja për bursa të ipet ndonjë përparësi, te kriteri i notave ose dikund tjetër në rregullore.

z.Muhamet Mehmeti; Edhe unë mendoj se nuk është e nevojshme të ketë një ndryshim të tillë përveç te neni 3.8 të ndryshohet.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, me propozimin**

për ndryshim si vijon: Te neni 3.8 i rregullores të shlyhet shkurtesa (RAE) dhe në vend të saj të shkruhet (Komuniteti Ashkali, Rom dhe Egjiptas)

Pika 4

Raport Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmetit drejtor i DBF-së.
z.Besnik Ahmeti, DBF; Kemi dy ndryshime të rregullorja për Taksa të neni 8.2.5 të veteranët dhe e dyta të neni 11.3.3 që ka të bëjë me pagesën e rregullimit të fëmijëve në Çerdhe. Në vazhdim Drejtori lexoi raportin e shpenzimeve (shih dokumentin).

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Tek ZKKK-ja buxheti ka qenë i planifikuar 6.236.62 janë shpenzuar 5.800 euro. Pyetja ime është nëse nuk ka funksionuar zyrja si janë hargjuar këto mjete?

z.Muhamet Mehmeti; Nga muaji Maj Ibrahim Demiri ka dalë në pension. Kryeatri e ka autorizuar Elfetin dhe ajo i ka kryer kërkesat. Unë i kam plotësuar dhe 4 kanë qenë nga Shtimja dhe 2 nga fshati Gjyrvkocv.

z.Besnik Seferi; Ky është një ndër raportet më të mira që ka ardhur në Kuvend. Unë po flasë në bazë të shifrave që i kemi kështu që 95.62% të Buxhetit është realizuar përkatsisht është shpenzuar, dhe për këtë arsye edhe kemi fituar grantin e performancës, prandaj ky raport është për ta miratuar.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë nuk po e di se çka ka ndodhë me shpenzimet e ZKKK-së.

Kimete Ukaj, zyrtare për Buxhet; Ibrahim Demiri ka punuar deri në muajin Maj, dhe këto mjete janë hargjuar sepse kërkesat kanë ardhur për pagesë dhe ne i kemi kryer këto pagesa. Sa i përket Subvencioneve, ato nuk janë nga Granti, por nga të hyrat vetanake, të cilat janë 8000 euro dhe janë shpenzuar rrafsh 8000 euro. ZKKK-ja siq e dini është te Zyra e Kryetarit.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; A ka mjete për një zyrtar?

Kimete Ukaj, zyrtare për Buxhet; Po paret janë të ndara.

Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Raportin Vjetor Buxhetor (shpenzimet) për vitin 2023.

Pika 5

Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes (Pas diskutimit Publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bardhyl Rushitit drejtor i DSHP.
z.Bardhyl Rushiti, DSHP; Diskutimin publik për këtë rregullore e kemi mbajtur sipas vendimit që e ka miratuar Kuvendi. Kemi disa propozime të cilat i lexoi (shih dokumentin). Te dita e dielë nuk ka ndryshim nuk lejohet të punohet përveç Gastronomisë, edhe sallonet për femra. Kujdestari do të ketë edhe te barnatoret edhe te marketet ushqimore.

z.Besnik Seferi; Te neni 6 kërkoj të sqarohet pak.

z.Bardhyl Rushiti, DSHP; Te ky nen bëhet fjalë për shitoret e rrymës dhe e kemi bërë që verës me punu deri ora 20.00h ndërsa dimrit deri në ora 19:00h.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Rregulloren për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes.**

Pika 6

Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë, mendojë se është mirë sepse edhe anëtarët e Komitetit mundën me marrë pjesë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për zgjedhjen e Komisionit për ndarjen e titujve të nderit.**

Pika 7

Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Programin Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes.**

Pika 8

Propozim-Vendim për ndarjen e subvenc. për nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë e di që kjo është bërë edhe vitin e kaluar por tash paska edhe ca ndryshime ndoshta na tregon ndokush pak më detaisht.

z.Besnik Seferi; Në bazë të diskutimeve që kemi pas kemi ardhë në përfundim që rritja të bëhet e përshkallëzuar mbi bazën e numrit të fëmijëve nga nënat lehona, dmth. në formë të rritjes graduale. Por shumën do ta prezantojnë Financat në bazë të analizave të buxhetit që do ti bëjnë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për ndarjen e subvencioneve për Nënat Lehona për fëmijët e lindur në vitin 2024.**

Pika 9

Propozim-Vendim për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërrmarrjes Publike Lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; E di që KRM "Pastërtia" ka mjaft probleme, por drejtori sigurisht që do të na sqaton më shumë, në vazhdim fjalën ja dha drejtorit.

z.Bardhyl Rushti, DSHP; Ne kemi bërë një propozim për të filluar procedurat për themelimin e një ndërrmarrje komunale publike. Kjo do të diskutohet në Kuvend dhe do të merret një vendim. Në Ministri sigurisht që duhet me mbrojtë këtë propozim tonin. Po shpresojë që në vitin 2025 me fillu me punën e ndërrmarrjes së re publike në kuadër të Komunës së Shtimes.

z.Besnik Seferi; E tha drejtori për arsyen e themelimit. Unë jam pjesë e kompanis publike "Pastërtia" sepse jam anëtarë i Komisionit të Aksionarëve. Kjo nismë është ardhur nga drejtoria dhe i përgëzojë. Si kompetencë duhet të kalojë në DSHP, sepse në kompani ka padrejtësi të madhe ndaj punëtorëve.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për Inicimin e procedurës të themelimit të Ndërrmarrjes publike lokale për kryerjen e shërbimeve publike në Komunën e Shtimes.**

Pika 10

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; E përgëzojë drejtorin për pjesëmarrje në mbledhje sepse na ndihmon shumë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; E falenderojë drejtorin Bardhyl Rushiti për pjesëmarrje në mbledhje. Meqenëse diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:47h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

